Gjergj Kastrioti
Skënderbeu

**VENDIM**

**NR._24_,Dt. 05.03.2012**

**I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE SHOQERISE ANONIME**

**"KANTINA E PIJEVE GJERGJ KASTRIOTI SKENDERBEU" SH.A.**

Ne mbledhjen e Dt. 05 Mars 2012 , te organizuar ne seline e shoqerise ne adresen, Rr. Bajram Tusha, Rrashbull, Durres nen drejtimin e Kryetarit te Keshillit Mbikqyres Z. Lefter Koka, mbledhje e zhvilluar ne pranine e aksionereve, te cilet perfaqesojne 82.14% te aksioneve, pra me shume se ½ e aksioneve me te drejte vote, pra me quorum te kerkuar per vendime te vlefshme, u

**KONSTATUA SE:**

Keshilli Mbikqyres i Shoqerise perbehet aktualisht nga 3 anetare: Lefter Koka- Kryetar, Ilirjan Zhapa- anetar dhe Gezim Shkembi- anetar, mandati i te cileve shtrihet nga data 10.07.2009-10.07.2012.

Bazuar ne kerkesen e Z. Lefter Koka per doreheqje nga posti i anetarit te Keshillit Mbikqyres per shmangien e konflikt interesit behet e nevojshme zgjedhja e Anetarit dhe Kryetarit te ri. Kjo procedure ligjore dhe kjo mbledhje asambleje realizohet konform Ligjit nr. 9367,dt. 07.04.2005 nenit 28/ a per "Parandalimin e Konfliktit te interesave ne ushtrimin e funksioneve publike".

Me votimin pro te 278.900,62 ne vlere aksioni apo 82.14 % te aksioneve . (Nga ku 214.387,45 te zoteruara nga aksioneri L.Koka dhe 64.513,17 te zoteruara nga aksioneri I.Zhapa) Asambleja e Pergjithshme

**VENDOSI**

1. Pranimin e kerkeses per doreheqje nga posti i anetarit te Keshillit Mbikqyres te z. Lefter Koka.
2. Emerimin e anetarit te Ri te Keshillit Mbikqyres z. Isuf KOKA i Datelindjes 26.03.1967, me Nr. Karte Identiteti G70326184Q ,lindur dhe banues ne Durres.
3. Emerimin e Kryetarit te Keshillit Mbikqyres z. Isuf KOKA

Mandati i tij fillon nga data 05.03.2012 deri me 10.07.2012.
Masa e shperblimit te funksionit te Kryetarit eshte 30.000 lek/muaj.
Autorizohet Administratori i Shoqerise te depozitoje kete veprim prane QKR per kryerjen e rregjistrimeve perkatese.

4. Miratimin e Statutit te Ri te ndryshuar te Shoqerise.

| | | |
|---|---|---|
| Aksioneri | Lefter Koka | Lefter Koka |
| Aksioneri | Ilirjan Zhapa | ILIRJAN ZHAPA |
| Drejtuesi Mbledhjes | Lefter koka | Lefter Koka |
| Sekretare | Erneste Asllani | Erneste Asllani |

KANTINA GJERGJ KASTRIOTI DURRES Skënderbeu

*Kantina e Pijeve "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" Sha*
Rruga: Bajram Tusha, Rrashbull, Durrës - Tel. 00355/5264628 - Fax 00355/5264627

# STATUTI

# I SHOQERISE ANONIME

## "Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Sh. A.

*Ne mbeshtetje te kerkesave te nenit 230 te Ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", brenda afatit ligjor te parashikuar ne te, asambleja e pergjithshme e shoqerise , miraton kete Statut te shoqerise, duke pershtatur organizimin dhe funksionimin e saj, sipas ligjit te ri ne fuqi.*
*Ky statut eshte njekohesisht shprehje e ndryshimeve statutore te bera nder vite ne kete shoqeri te rezultuara edhe nga vendimet perkatese gjyqesore dhe regjistrimet prane QKR. Per rrjedhim, permbajtja vijuese eshte pasqyrim i situates aktuale dhe percakton rregullat per funksionimin ne vazhdimesi, te shoqerise "Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Sh. A.*

**Neni 1**
**Forma**

1.1 Shoqëria eshte shoqeri anonime , e cila ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe vecanërisht: me Kushtetuten, ligjin nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", ligjin nr. 9723, date 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" , legjislacionit tatimor dhe legjislacionit specifik qe mbulon fushen e veprimtarise se saj tregtare .

1.2. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e rregjistrimit të saj në rregjistrin tregtare (QKR) nga organet kompetente dhe në përputhje me ligjin.

KANTINA GJERGJ KASTRIOTI DURRES
Skënderbeu

## Neni 2
## Emri

Emri i shoqerise eshte " Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Sh.A Durres.

## Neni 3
## Selia dhe Kohezgjatja e Shoqerise

3.1 Shoqeria e ka seline e saj ne adresen : Rruga " Bajram Tusha", Rrashbull, Durres.

3.2.Transferimi i selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër bëhet me miratimin e asamblese se pergjithshme , ku jane te pranishem apo te perfaqesuar me shume se gjysma e ortakeve dhe vendoset me 3 / 4 e votave te ortakeve pjesemarres.

3.3. Veprimtaria e saj do te shtrihet ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise ; mund te shtrihet edhe jashte shtetit .

3.4. Shoqeria ka te drejte te krijoje brenda dhe jashte shtetit dege, zyra perfaqesimi.

3.5 Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë për një periudhë kohe të pakufizuar.

3.6. Me vendim te asamblese se pergjithshme kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit mund te kufizohet dhe ky vendim dergohet menjehere per regjistrim ne QKR.

## Neni 4
## Objekti i veprimtarise

4.1 Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

Prodhim, tregtim, pije alkolike, vere, pije joalkolike. Import-eksport te produkteve te veta dhe te atyre qe mund te sigurohen nga bartesi.

Import-eksport lendesh te para e ndihmese dhe nenprodukteve qe rrjedhin nga perpunimi industrial i tyre. Sherbime tranziti, magazinash, komisione dhe perfaqesime te personave juridike e fizike, etj.

Shkembime valutore, transaksione te letrave me vlere, etj.

4.2 Shoqeria, brenda caqeve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje cdo operacion

tregtar e financiar qe lidhet drejtperdrejt ose terthorazi me objektin e saj.

4.3 Shoqeria mund te hape veprimtari te reja, te krijoje sipermarrje te tjera, ose te marre pjese ne sipermarrje te tjera, si brenda dhe jashte vendit, pa cenuar objektin kryesor te shoqerise.

## Neni 5
## Kohezgjatja dhe Vula

5.1 Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj per nje afat kohor te pacaktuar.

5.2 Me vendim te asamblese se pergjithshme, i cili merret me shumice te kualifikuar , kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit mund te kufizohet dhe ky vendim dergohet menjehere per regjistrim ne QKR.

5.3. Shoqeria ka vulen me specimentet e saj

KANTINA GJERGJ KASTRIOTI DURRES Skënderbeu

## Neni 6
## Kapitali i Regjistruar

6.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 339.543.000 (treqind e tridhjete e nente milione e peseqind e dyzete e tre mije) leke, i ndare ne 339.543 (treqind e tridhjete e nente mije e peseqind e dyzete e tre) aksione te numertuar nga 1 deri ne 339.543, me vlere nominale 1000 leke per aksion.
6.2 Ndarja e aksioneve dhe perqindjet e zoterimit te aksionereve ne kapitalin e shoqerise jane te shprehura ne listen e aksionereve dhe certifikatat e zoterimit te aksioneve te depozituara ne Qendren Kombetare te regjistrimit ( QKR) dhe ne Qendren e Regjistrimit te Aksioneve, te grupuara si me poshte :

- **Lefter Koka 67.97% te aksioneve te kapitalit, 230.800,79 aksione**
- **Ilirjan Zhapa 19.00 % te aksioneve te kapitalit, 64.513,17 aksione**
- **Punonjesit e shoqerise 3,46 % te aksioneve te kapitalit, 11.751,66 aksione**
- **Aksioneri shtet ( Ministria e Financave) 9.57 % te aksioneve te kapitalit, 32.477,38 aksione.**

Aksioneret pergjigjen personalisht per detyrimet e shoqerise, ata mbulojne humbjet e shoqerise vetem me vleren e pashlyer te aksioneve te nenshkruara.

**Neni 7**

**Zmadhimi i kapitalit themeltar**

7.1 Kapitasli themeltar i regjistruar i shoqerise mund te zmadhohet sipas modaliteteve dhe menyrave te parashikuara ne nenet 168 deri 180 te ligjit " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

7.2 Zmadhimi i kapitalit themeltar mund te kryhet vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme, vendim I marre kur te pranishem ose te perfaqsuar jane aksioneret qe zoterojne me shume se 50% (pesedhjete perqind) te kapitalit te shoqerise dhe qe votojne pro me shume se ¾ ose 75% (shtatedhjte e pese perqind) e tyre. Ketu ben perjashtim rasti i parashikuar ne nenin 176 te ligjit per "Tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Kapitali i regjistruar nuk mund te zmadhohet nese nuk jane shlyer ende kontributet per aksionet e nenshkruara me pare.

7.3 Zmadhimi i kapitalit behet efektiv ne daten e regjistrimit te realizimit te tij ne QKR. Aksionet e reja nuk mund te emetohen dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre nuk mund te transferohen para regjistrimit te zmadhimit te kapitalit prane QKR.

**Neni 8**

8.1 Kur zmadhimi I kapitalit behet me emetim te aksioneve te reja, kundrejt kontributeve te reja, aksioneret e shoqerise gezojne te drejten e parablerjes per to, ne perpjestim me pjesen e kapitalit te regjistruar, qe perfaqsojne aksionet e zoteruara prej tyre. Kjo e drejte duhet te ushtrohet brenda 20 diteve pas publikimit te kryer prane QKR per zmadhimin e kapitalit.
8.2 Kjo e drejte mund te kufizohet apo perjashtohet nga vendimi I asamblese se pergjithshme per zmadhimin e kapitalit.

**Neni 9**

KANTINA GJERGJ KASTRIOTI DURRES Skënderbeu

9.1. Kur zmadhimi i kapitalit behet me aktivet e shoqerise, aksionaret kane te drejte te zoterojne aksionet e emetuara rishtazi ne perpjestim me aksionet e tyre, perpara rritjes se kapitalit. Cdo vendim i asamblese qe bie ndesh me kete rregullim, eshte i pavlefshem.

## Neni 10
## Transferimi dhe shitja e aksioneve

10.1. Aksionet jane lirisht te tregtueshme midis aksionereve te shoqerise.

10.2. Shitja e aksioneve tek te tretet joaksionere, me perjashtim te trashegimise, behet pasi te jete respektuar e drejta e parablerjes nga aksionaret ekzistues te shoqerise.

Aksioneret e shoqerise gezojne te drejten e parablerjes se aksioneve, ne rast se njeri apo disa nga aksioneret kerkon t'i shese ato personave te trete jo aksionere. Aksioneri i cili deshiron t'i shese aksionet e tij te treteve, i paraqet Keshillit Mbikqyres nje kerkese me shkrim, ku percaktohet identiteti i personit qe deshiron t'i bleje, numri i aksioneve qe parashikon transferimi i pronesise dhe cmimi i ofruar. Keshilli Mbikqyres brenda 5 diteve nga marrja e kerkeses, ben njoftimin perkates ne faqen e internetit te shoqerise apo njofton aksioneret ekzistues me shkrim ose nepermjet postes elektronike. Nese aksioneret ekzistues cmojne te ushtrojne te drejten e parablerjes, duhet t'i komunikojne pergjigjen me shkrim, aksionerit te interesuar dhe Keshillit Mbikqyres, brenda 10 diteve nga data e marrjes se njoftimit. Mungesa e komunikimit brenda ketij afati, barazohet me mosushtrimin e te drejtes se parablerjes.
Aksionet mund t'i transferohen cdo personi fizik e juridik, shqiptar ose i huaj.

## Neni 11
## Te drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionet

11.1.Çdo aksion i jep zoteruesit te tij te drejten e marrjes te nje pjese nga fitimet e shoqerise ne perpjestim me vleren e kapitalit te regjistruar , qe aksionet e secilit aksionar perfaqesojne.

11.2. Pronesia e nje aksioni permban te drejten e plote te aderimit ne Statutin e shoqerise dhe ne vendimet e Asamblese.

11.3. Pervec ketyre, aksioni jep zoteruesit te tij te drejten e votes dhe te perfaqsimit ne Asamblene e pergjithshme ne kushtet e parashikuara nga ligji ose te caktuara ne kete statut.

11.4. Aksioneret nuk pergjigjen personalisht per detyrimet e shoqerise e qe mbulojne humbjet e saj vetem me vleren e pashlyer te aksioneve te nenshkruara.

11.5. Te drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionet e ndjekin ate ne cfaredo forme qe transferohet nga njera dore ne tjetren.

11.6. Nje aksion i shoqerise mund te zoterohet nga nje apo me shume persona, te cilt pergjigjen ne menyre solidare per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi.

11.7. Aksionari nuk mund te ushtroje te drjeten e votes , nese asambleja e pergjithshme duhet te vendose per :

- vleresimin e veprimtarise se tij
- faljen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- dhenien apo jo te perfitimeve te reja
- ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria

11.8. Aksionari qe pengohet te ushtroje te drejtat qe rrjedhin nga zoterimi i aksionit te shoqerise, ka te drejten te kerkoje nepermjet gjykates ndalimin e cenimit apo te kerkoje demshperblim. Padia duhet te ngrihet brenda 3 vjeteve pas pengimit te ushtrimit te se drejtes.

## DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

### Neni 12

### Organet e shoqerise

**12.1.** Organet drejtuese e administruese te shoqerise jane te organizuara sipas sistemit me dy nivele dhe perbehen nga:

- Asambleja e Pergjithshme
- Keshilli Mbikqyres
- Administratori

### Neni 13

### Asambleja e pergjithshme

13.1 Natyra e Asamblese dhe karakteri i detyrueshem i vendimeve.

Asambleja e pergjithshme eshte organi me i larte vendimmarres i shoqerise dhe vendimet e saj jane te detyrueshme per te gjithe aksioneret.

Vendimet e Asamblese se Pergjithshme detyrojne te gjithe aksioneret, pavaresisht nese votojne kunder apo mungojne.

13.2 Thirrja dhe vendi i mbledhjes se Asamblese

Te drejten e thirrjes se Asamblese e kane :

- administratori
- anetaret e keshillit mbikqyres

aksionaret qe perfaqesojne 5 % te kapitalit te regjistruar te shoqerise .

Asambleja e pergjithshme thirret ne rastet e percaktuara ne ligjin " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" vecanerisht ato te parashikuara ne nenin 136 te tij, ne rastet e parashikuara nga ligje te tjera , nga statuti, dhe sa here qe mbledhja nevojitet per te mbrojtur interesat e shoqerise. Mbledhja e zakonshme thirret te pakten nje here ne vit.

Asamblete e pergjithshme mblidhen ne seline e shoqerise ose ne cdo vend tjeter te treguar ne njoftimin per thirrjen e mbledhjes se Asamblese se Aksionereve. Thirrja behet nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nepermjet postes elektronike, e cila u dergohet se bashku me rendin e dites te gjithe aksionareve jo me vone se 21 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen

Njoftimi i thirrjes se mbledhjes se asamblese se pergjithshme se bashku me rendin e dites, vendosen edhe ne faqen e internetit te shoqerise, shoqeruar me dokumentacionin perkates.

Thirrja e mbledhjes mund tu njoftohet aksionareve edhe nepermjet botimit ne nje gazete te perditeshme me shperndarje ne gjithe vendin , ne rastin kur shoqeria ka shume aksionare.

13.3 Pjesemarrja dhe perfaqesimi ne Asamble

KANTINA GJERGJ KASTRIOTI DURRES
Skënderbeu

Votat e aksionereve kane vlere proporcionale me pjesen e tyre ne kapitalin e shoqerise. Cdo aksion ka te drejten e nje vote.

Cdo aksioner mund te perfaqesohet ne asamble nepermjet nje aksioneri tjeter ose nepermjet nje personi te trete, duke qene keta te pajisur me autorizim , i cili jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme , duke perfshire edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Ndalohet qe administratori dhe anetaret e keshillit mbikqyres te veprojne si perfaqesues re aksionareve ne asamble.

Aksionaret qe nuk jane te pranishem, mund te marrin pjese ne mbledhje me mjete te ndryshme komunikimi perfshire mjetet elektronike, por me kushtin qe te garantohet identifikimi i tyre. Keto mjete elektronikeduhet te perfshijne, por pa u kufizuar ne to :

- transmetimin e mbledhjes se asamblese ne kohe reale
- komunikim te ndersjellte, gje qe i jep mundesi aksionereve te shprehen ne kohe reale ne mbledhje , ndonese kane vendndodhje tjeter
- mekanizma qe bejne te mundur procesin e votimit , pa qene nevoja te caktojne perfaqesus te autorizuar per te marre pjese fizikisht ne mbledhje.

Mbledhjet e asamblese mund te realizohen e te quhen te vlefshem edhe nepermjet video-konferences. Ne kete rast mbledhja regjistrohet dhe shiriti magnetik autentik ruhet ne arkivin e shoqerise.

13.4 Drejtimi i mbledhjes dhe procesverbalet

Mbledhjet e Asamblese drejtohen nga Kryetari i Keshillit Mbikqyres ose, ne mungese te tij, nga nje anetar i Keshillit Mbikqyres i caktuar nga Kryetari. Drejtuesi i mbledhjes cakton edhe nje sekretar ( qe mund te mos jete aksioner) per te mbajtur proces-verbalin. Proces-verbali pervec te tjerave permban edhe :

- Daten dhe vendin e mbledhjes
- Numrin e aksionereve te pranishem dhe kuorumin e arritur
- Drejtuesin e mbledhjes dhe sekretarin
- Rendin e dites
- Dokumentat dhe raportet qe jane diskutuar
- Nje permbledhje te debateve
- Rezultatet e votimeve
- Vendimin e marre
- Qendrimin e kryetarit per vendimmarrjen dhe te aksionareve kunder.

Proces-verbalet e mbledhjeve ruhen ne seline e shoqerise. Administratori eshte pergjegjes per ruajtjen e tyre.

Gjate mbledhjes pergatitet lista e aksionareve te pranishem dhe te perfaqesuesve e cila nenshkruhet prej tyre.

13.5 Kuorumi dhe votimi

Ne asamblene e pergjithshme kuorumi llogaritet per teresine e aksioneve qe perbejne kapitalin e regjistruar te shoqerise . E drejta e votes qe u perket aksioneve eshte perpjestimore me kapitalin qe ato perfaqsojne. Cdo aksion i jep zoteruesit te tij te drejten e nje vote. Votimi kryhet i vecante



KANTINA GJERGJ KASTRIOTI DURRES Skënderbeu

per cdo ceshtje apo vendim ; votimi mund te jete i hapur apo i fshehte, kur jane ratet e parashikuara ne ligj .

13.6 Venia e dokumentave ne dispozicion te aksionereve
Shoqeria mban dhe ve ne dispozicion te aksionereve, ne kushtet dhe afatet e parashikuara ne ligj, dokumentet e llogarite vjetore qe shqyrton asambleja.

13. 7 . Vendimet e asamblese nenshkruhen nga kryetari i mbledhjes se asamblese . Proces verbali i mbledhjes neneshkruhet nga kryetari dhe sekretari i mbledhjes . Vendimet dhe proces verbalet ruhen ne arkivin e shoqerise se bashku me listen e aksionereve te pranishem apo perfaqesuesve te tyre, me nenshkrimet perkatese.

**Neni 14**

**Kuorumi dhe marrja e vendimeve me shumice te zakonshme**

14.1. Asambleja e pergjithshme merr vendime te vlefshme, ne rastin e ceshtjeve qe vendosen me shumice te zakonshme, nese aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar, zoterojne me shume se 30 % te aksioneve me te drejte vote (kuorumi) ; dhe votojne pro mbi 50 % e aksionareve qe marin pjese.

14.2. Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit , ajo mblidhet serish jo me vone se 30 dite me rend dite te njejte.

14.3. Asambleja e pergjithshme vendos me shumice te zakonshme per keto ceshtje :

- Percaktimin e politikave tregtare
- Emerimin e shkarkimin e anetareve te Keshillit Mbikqyres
- Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- Percaktimin e shpeblimeve per anetaret e keshillit mbikqyres, te likuiduesve dhe eksperteve kontabel.
- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurise se veprimtarise
- Pjestimin e aksioneve dhe anullimin e tyre
- Ndryshime ne te drejtat qe lidhen me aksione te llojeve e kategorive te vecanta
- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykimet ndaj organeve te administrimit
- Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te saj
- Çdo ceshtje tjeter qe i njihet nga ligji, ose ky Statut.

**Neni 15**

**Kuorumi dhe marrja e vendimeve me shumice te kualifikuar**

15.1. Asambleja e pergjithshme merr vendime te vlefshme, ne rastin e ceshtjeve qe vendosen me shumice te kualifikuar, nese aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar, zoterojne me shume se 50 % te aksioneve me te drejte vote (kuorumi) ; dhe votojne pro mbi 75 % e aksionareve qe marin pjese.

15.2. Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit , ajo mblidhet serish jo me vone se 30 dite me rend dite te njejte.

15.3. Asambleja e pergjithshme vendos me shumice te kualifikuar per keto ceshtje

1. Per ndryshimet ne statut ose te zevendesoje me nje statut te ri kete statut te shoqerise
2. Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar te shoqerise, ne baze te procedurave te percaktuara me ligj
3. Shperndarjen e fitimeve
4. Riorganizimin (bashkimin , ndarjen , shnderrimin e forms ligjore te shoqerise) dhe prishjen e shoqerise.

**Neni 16**

**Keshilli Mbikqyres**

16.1. Keshilli Mbikqyres i shoqerise zgjidhet nga Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve te shoqerise cdo 3 vjet. Ai perbehet nga 3(tre) anetare, njeri prej te cileve eshte kryetar.

16.2. Anetaret e Keshillit Mbikqyres jane te rizgjedhshem. Ata mund te revokohen nga Asambleja e Pergjithshme e cila merr vendim me shumjice te thjeshte..

Anetaret e keshillit Mbikqyres jane individe, per zgjedhjen e tyre duhet te respektohen kerkesat e parashikuara ne nenin 156 te ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

16.3. Keshilli mbikqyres zgjedh kryetarin dhe nenkryetarin, i cili ushtron tagrat e kryetarit kur ky i fundit nuk eshte ne mundesi per t'i kryer ato personalisht.

16.4. Mbledhjet e Keshillit mbikqyres behen me thirrjen e Kryetarit sa here qe e kerkon interesi i shoqerise ose te pakten njehere ne 3 muaj. Mbledhjet mbahen zakonisht ne seline e shoqerise, apo diku tjeter sit e cmohet me e mundshme ; rend ii dites caktohet nga kryetari.

Cdo anetar i keshillit mbikqyres mund te jape nje mandate nje anetari tjeter per ta perfaqsuar ne mbledhjet e keshillit.

16.5. Shqyrtimet dhe vendimet e keshillit Mbikqyres jane te vlefshme kur numri i anetareve te pranishem ne mbledhje eshte me shume se gjysma e anetareve ne funksion.

Vendimet merren me shumicen e votave te anetareve te pranishem dhe te perfaqsuar. Ne rast votash te barabarta , vota e kryetarit eshte percaktuese. ( ne rastin e zgjedhjes ose shkarkimit te Administratorit te shoqerise kerkohet edhe vota e Kryetarit te Keshillit Mbikqyres).

16.6. Shqyrtimet dhe vendimet e Keshillit Mbikqyres evidentohen me process-verbale, qe nenshkruhen kryetari.

Vendimet e Keshillit Mbikqyres mund te jene edhe qarkulluese. Per te realizuar kete lloj vendimi shperndahet projekti, mblidhen verejtjet dhe me pas firmoset vendimi perfundimtar pa u mbledhur anetaret fizikisht ne ndonje salle.

Mbledhjet e Keshillit mund te realizohen dhe te quhen te vlefshme edhe nepermjet video-konferences. Ne kete rast mbledhja regjistrohet dhe shiriti magnetic autentik ruhet ne arkivin e shoqerise.

16.7. Keshilli Mbikqyres i shoqerise ka kete perberje:

1. **Isuf Koka,** **Kryetar**
2. **Ilirjan Zhapa,** **Anetar**
3. **Gezim Shkembi,** **Anetar**

Funksionin e nenkryetarit e gezon Anetari " Gezim SHKEMBI"

Keshilli Mbikqyres ka keto kopetenca:

- Kontrollon e mbikqyr zbatimin e politikave tregtare te shoqerise nga administrator

KANTINA GJERGJ KASTRIOTI DURRES Skënderbeu

- Pergatit, me kerkese se asamblese se pergjithshme, marrjen e masave, qe jane ne kompetence te kesaj te fundit, t' i rekomandoje asaj vendime te nevojshme per t'u marre, si dhe te zbatoje vendimet e asamblese.
- Therret mbledhjen e asamblese se pergjithshme sa here qe vleresohet e nevojshme per interesat e shoqerise.
- Kujdeset qe shoqeria te respektoje ligjin dhe standartet e kontabilitetit
- Shqyrton e kontrollon librat kontabel, dokumentet dhe aktivet e shoqerise
- Siguron se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurise se veprimtarise, si dhe detyrimet e tjera te raportimit e publikimit, te detyrueshme ne baze te ligjit apo statutit, te kryhen me saktesi nga administratoret. Keto dokumente duhet te miratohen e te nenshkruhen nga te gjithe anetaret e keshillit per t'iu paraqitur asamblese se pergjithshme, se bashku me nje raport te keshillit mbikqyres per miratim dhe nje pershkrim per mbikqyrjen e menaxhimit gjate te gjithe vitit financiar.
- Siguron se auditimi i librave dhe regjistrimeve kontabel te kryeht te pakten nje here ne vit nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar asamblese se pergjithshme, t' u vihet ne dispozicion te gjithe anetareve te keshillit e administratorit.
- Emeron dhe shkarkon administratorin
- Percakton shpeblimin e administratorit
- Kryen veprime te tjera qe percaktohen me ligj dhe ne statut
- Miraton strukturen organizative te shoqerise dhe ndryshimet e saj, kriteret e punesimit dhe te pagave, si dhe rregulloren e brendshme te shoqerise
- Autorizon dhenien e dorezanive dhe garancive
- Autorizon kryerjen e investimeve tej atyre te parashikuara ne programin financiar vjetor
- Autorizon hapjen e veprimtarive ose degeve te reja, shkrirjen, bashkimin ose mbylljen (teresisht ose pjeserisht) te veprimtarive dhe degeve te shoqerise
- Autorizon pjesmarrjen ne shoqeri te tjera
- Autorizon shitjen dhe shkembimin e pasurive qe perbejne active te qendrueshme te shoqerise
- Autorizon negocimin, perfundimin apo ndryshimin e cdo kontrate me afat apo per nje shume ne leke apo valute mbi kufirin e asaj te percaktuar cdo vit.
- Kryen te gjitha verifikimet qe cmon te nevojshme dhe ka te drejte te kerkoje te njihet me dokumentat e duhura per permbushjen e detyrave te tij (kurse cdo 3 mujor nje raport te paraqitur nga Administratori)
- Miraton bilancin vjetor e ia paraqet Asamblese se zakonshme te Aksionereve
- Miraton praktikat e marketingut
- Miraton strukturen e tarifave te sherbimeve
- Therret e drejton mbledhjet e Asamblese

KANTINA GJERGJ KASTRIOTI DURRES Skënderbeu

- Zgjedh Administratorin ( dhe administratore te tjere nese do te kete me shume se nje ) me votat e te pakten dy anetareve te Keshillit Mbikqyres, nje nga te cilet duhet te jete Kryetar i Keshillit.

16.9. Skema e shperblimeve te anetareve te keshillit mbikqyres pergatitet nga ky keshill , por miratohet nga asambleja e pergjithshme.

**Neni 17**

**Administratori**

17.1. Keshilli Mbikqyres emeron nje ose me shume persona fizike si administratore, per nje afat jo me te gjate se tre vjet, me te drejte rizgjedhje. Emerimi prodhon efekte pas regjistrimit ne QKR . Administratoret mund te shkarkohen para afatit nga Keshilli Mbikqyres.

Administratoret nuk mund te bejne pjese ne Keshillin Mbikqyres te shoqerise, por mund te jene aksionere te shoqerise

17.2. Menyra dhe masa e shperblimit te Administratoreve caktohet nga Keshilli Mbikqyres qysh ne aktin e emerimit. Aktualisht shoqeria drejtohet nga nje administrator, por ne vazhdimesi Keshilli Mbikqyres mund te emeroje edhe me shume se nje administrator, duke bere edhe ndarjen e kompetencave mes tyre , nese e cmon nje gje te tille, si dhe te percaktoje menyren e administrimit prej tyre.

17.3. Administratori eshte pergjegjes per drejtimin dhe mirfunksionimin e shoqerise , si dhe per mireadministrimin e pasurise se saj. Ai zbaton metodat dhe menyrat qe i cmon me te mira e me te pershtatshme per te realizuar detyrat e percaktuara nga Asambleja e Keshilli Mbikqyres.

Administratori ka kompetenca te plota per te vepruar ne cdo rrethane ne emer te shoqerise, por kufizohet nga ato kompetenca qe ligji dhe ky Statut ua ka dhene shprehimisht Asamblese se Pergjithshme dhe Keshillit Mbikqyres.

Te gjitha aktet dhe vendimet e Administratorit firmosen, vulosen, protokollohen dhe ruhen ne arkiv.

17.4. Administratori ka keto kompetenca:

- Kryen te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise se shoqerise
- Perfaqeson shoqerine
- Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregult te dokumenteve dhe librave kontabel
- Pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise, qe ia paraqet keshillit mbikqyres per miratim, se bashku me prpozimet per ndarjen e fitimeve , per te vazhduar me pas me paraqitjen per miratim ne asamblene e pergjithshme.
- Krijon nje sistem monitorimi e njoftimi te hershem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e shoqerise
- Kryen regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme te te dhenave te shoqerise
- Raporton para keshillit mbikqyres per zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve me rendesi te vecante qe lidhen me veprimtarine e shoqerise
- Jep direktiva per zbatimin e politikave tregtare te shoqerise
- Propozon vendime e akte te tjera per Keshillin Mbikqyres ose Asamblene e Aksionereve



KANTINA GJERGJ KASTRIOTI DURRES Skënderbeu

- Kerkon thirrjen e Asamblese se Pergjithshme kur Keshilli Mbikqyres refuzon autorizimin per nje operacion, per te cilin I nevojitet ky autorizim
- Emeron dhe shkarkon shefat e sektoreve dhe personelin tjeter administrative, si dhe percakton menyren dhe pagat e tyre
- Miraton kontraten tip te punes
- Merr vendime per maredheniet financiare brenda shoqerise dhe me personat e trete jashte saj
- Negocion dhe nenshkruan kontratat me institucionet financiare per kreditimin e shoqerise ne cdo lloj vlere
- Autorizon shperblimet e vecanta e honoraret per punonjes te vecante te shoqerise dhe persona te tjere jashte saj

17.5. Ne cdo rast , Administratori eshte i detyruar qe, per veprimtarine e tij ne pergjithesi ose per probleme te vecanta, te raportoje ne Asamblene e Aksionereve (kur kete e kerkojne aksionere qe zoterojne jo me pak se 1/5 e kapitalit te shoqerise) dhe ne Keshillin Mbikqyres ( kur kete e kerkon Kryetari i Keshillit ose jo me pak se dy anetare te tij).
Administratori ka te drejte te delegoje pjese te caktuara te kompetencave te tij, ne baze te nje autorizimi a prokure.

17.6. Administrator i shoqerise eshte Z. Krenar Hasanaj.

**Neni 18**

Administratoret dhe netaret e kKeshillit Mbikqyres qe veprojne ne kundershtim me detyrat dhe shkelin standartet e kujdesit te parashikuara ne nenin 163 te ligjit " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" jane te detyruar t' i shperblejne shoqerise demetn qe rrjedhin nga shkeljet. Ata kane barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre rregullisht sipas standarteve te kerkuara.

**Neni 19**

**Ndalimi , konflikti i interesit dhe personat e lidhur.**

- Personat e autorizuar per te perfaqesuar ose per te mbikqyrur shoqerine , per lidhjen e kontratave dhe hyrjen ne maredhenie te tjera me shoqerine tregtare si dhe
- Per lidhjen e cdo kontrate apo maredhenie tjeter mes vete shoqerise dhe paleve te treta duhet te respektohen kerkesat e parashikuara ne nenin 13, te Ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

**KONTABILITETI DHE FINANCAT E SHOQERISE**

**Neni 20**

**Aftesia paguese**

Shoqeria krijon marzhin e aftesise paguese te mjaftueshme per veprimtarine e saj, duke perfshire te gjithe vleren e pasurive, si kapitalin e regjistruar, rezervat, fitimet e mbartura, etj.

**Neni 21**

**Ushtrimi financiar**

Ushtrimi financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron 31 Dhjetor te cdo viti.



KANA GJERGJ KASTRIOTI DURRES Skënderbeu

**Neni 22**

**Bilanci vjetor**

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe veprimtarise se saj, ne pajtim me kerkesat e ligjit. Per ndjekjen e gjendjes financiare Administratori , sipas struktures dhe permbajtjes te percaktuara ne planin kontabel, pergatit raportin mbi gjendjen financiare cdo tremujor si dhe ate vjetor.

Ne mbylljen e cdo viti financiar hartohet inventari i pasurise dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat ligjore per kontabilitetin, si dhe raporti vjetor mbi gjendjen financiare te shoqerise gjate ushtrimit te kaluar, ku parashikohen dhe ndryshime per te ardhmen e veprimtarite e tjera te shoqerise.

Keto dokumenta i jepen ekspertit kontabel nje muaj para mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme , i cili ben komentet e veta ne nje raport te vecante.

**Neni 23**

**Miratimi i bilancit**

Raporti per gjendjen financiare te shoqerise, i detajuar per te gjitha operacionet dhe per gjendjen e administrimit te shoqerise paraqitet nga Administratori ne fund te vitit financiar ne Keshillin Mbikqyres, i cili e miraton dhe ia paraqet Asamblese se Pergjithshme.

**Neni 24**

**Rezultati i ushtrimit financiar dhe rezervat**

Rezultati I ushtrimit financiar percaktohet si diference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit, duke perfshire ne keto te fundit edhe amortizimet , provizionet dhe taksat.

Nga fitimet e ushtrimit, te pakesuara kur eshte rasti me humbjet e mepparshme, hiqet te pakten 5 % per te krijuar rezerven ligjore. Heqja nga fitimet per rezerven ligjore pushon se qeni e detyrueshme kur kjo rezerve arrin 10 % te kapitalit te regjistruar.

Asambleja e pergjithshme ne rast nevoje mund te formoje edhe rezerva tge tjera nga fitimet vjetore.

Aksioneret kane te drejte te marrin pjesen e fitimit te destinuar per ndarje nga Asambleja e pergjithshme, proporcionalisht me pjesmarrjen e tyre ne kapitalin e regjistruar te shoqerise.

**Neni 25**

**Pergjegjesite ndaj shtetit**

Shoqeria ka llogarite e saj bankare dhe pergjigjet me fondet e saj per taksat dhe detyrimet e tjera ndaj shtetit.

**Neni 26**

**Ekspertet Kontabel te Autorizuar**

26.1. Kontrolli financiar ushtrohet nga nje ose disa eksperte te autorizuar, te licensuar konform legjislacionit shqiptar, te cilet emerohen nga Asambleja e pergjithshme dhe kryejne detyren e tyre ne pajtim me ligjin.

KANTINA GJERGJ KASTRIOTI DURRES Skënderbeu

**Neni 28**

**Ndryshimet e kapitalit themeltar**

Ndryshimet e kapitalit themeltar, zmadhimi ose zvogelimi I tij si dhe menyra e realizimit te tyre do te percaktohen konform dispozitave te ketij statuti , te ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", dhe te akteve te tjera ligjore ne fuqi.

**Neni 29**

**Riorganizimi i shoqerise**

29. 1. Riorganizimi i shoqerise nepermjet bashkimit, ndarjes apo shnderrimit te formes ligjore behet vetem pasi shoqerite kane qene te regjistruara te pakten nje vit.

29.2. Shndërrimi i shoqërisë aksionare ne shoqeri me përgjegjësi të kufizuar , behet vendim te asamblese se pergjithshme qe merret me shumice te kualifikuar , me pranine apo perfaqesimin e mbi 50 % te aksionareve dhe me miratimin e 3/ 4 e aksionareve pjesemarres .

**Neni 30**

**E drejta e komunikimit dhe informimit**

Cdo aksioner ka te drejten e komunikimit dhe te informimit te vazhdueshem.

Perpara mbledhjes se cdo Asambleje apo konsulte, cdo aksioner ka te drejten e njohjes se dokumentacionit e te informacioneve te tjera qe lidhen me problemet qe do te diskutohen ose konsultohen. Keto duhet ti vihen ne dispozicion aksionerit ne kushtet e percaktuara ne dispozitat ligjore dhe rregulloret ne fuqi.

**Neni 31**

**Fshehtesia e informacionit**

31.1. Te gjithe aksioneret, anetaret e Keshillit Mbikqyres, Administratori dhe te punesuarit e tjere te shoqerise jane te detyruar te ruajne fshehtesine e cdo informacioni apo te dhene ne lidhje direkte ose indirekte me shoqerine, per te cilat ata vihen ne dijeni gjate ushtrimit te aktivitetit te tyre, ose ne menyre te terthorte. Ata duhet te marrin te gjitha masat e nevojshme dhe te zbatojne procedurat te percaktuara per te penguar perhapjen ne cfaredolloj forme te informacionit, te ruajne sekretin tregtar dhe mos u japin informacion konkurenteve ne treg, lidhur me te dhena te cilat ndikojne ne rritjen e aktivitetit dhe efektivitetit te shoqerise.

31.2 .Te gjithe aksioneret, anetaret e Keshillit Mbikqyres, Administratori dhe te punesuarit e tjere te shoqerise pergjigjen per pasojat e demshme qe i shkaktohen shoqerise nga perhapja e paautorizuar e informacionit.

**Neni 32**

**Maredheniet me punonjesit**

Maredheniet e punes mes shoqerise dhe stafit, rregullohen ne baze te Kodit te Punes dhe legjislacionit mbi maredheniet e punes ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 33**

**Falimentimi, paaftesia ose vdekja e nje aksioneri**

Shoqeria nuk prishet kur falimenton, vdes apo shfaq paaftesi mendore ose fizike njeri prej aksionereve.



KANCELARIA GJERGJ KASTRIOTI DURRES Skënderbeu

26.2. Ekspertet kontabel jane te autorizuar qe ne cdo kohe te vitit, se bashku ose vec e vec, te bejne te gjitha verifikimet e kontrollit qe gjykojne te domosdoshme dhe mund te shfrytezojne te gjithe dokumentacionin e vleresuar sit e dobishem me ushtrimin e funksionit te tyre, ne vecanti, kontratat, librat e llogarise, dokumentat kontabel dhe regjistrat e procesverbaleve.

Detyrat dhe te drejtat e eksperteve kontabel te pavarur te shoqerise jane ato te parashikuara nga legjislacioni perkates.

Ekspertet kontabel informojne Keshillin Mbikqyres dhe Administratorin per :

- Kontrollet, verifikimet dhe sondazhet qe kane kryer
- Pjeset e bilancit dhe te dokumentave te tjera te kontabilitetit ku ata kane verejtje
- Parregullsite dhe pasaktesite qe kane zbuluar.

Ekspertet kontabel thirren ne mbledhjen e Keshillit Mbikqyres kur mbyllen llogarite e vitit financiar, si dhe ne mbledhjen e Asamblese. Ata jane pergjegjes si ndaj shoqerise, ashtu edhe ndaj te treteve per pasojat qe rrjedhin per fajin e nenvleftesimin e tyre gjate ushtrimit te funksioneve qe kane.

26.3. Shperblimet e eksperteve i ngarkohen shoqerise. Asambleja e pergjithshme , me rastin e miratimit te eksperteve, miraton edhe masen e shperblimit te tyre.

26.4. Maredheniet e eksperteve kontabel me shoqerine percaktohen ne nje kontrate midis tyre dheAdministratorit.

**Neni 27**
**Prishja dhe Likuidimi**

27.1. Shoqeria prishet :

- me vendim te asamblese se pergjithshme
- me hapjen e procedurave te falimentimit
- nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise.
- me vendim te gjykates
- per arsye te tjera te parashikuara ne statut

27.2. Kur shoqeria prishet, ajo vihet ne likuidim. Likuidimi behet ne pajtim me dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" e te ligjit" Per Proceduren e falimentimit".

27.3. Asambleja e pergjithshme emeron , shkarkon dhe zevendeson likuidatoret duke percaktuar edhe kompetencat qe ata kane.

27.4.Me hapjen e procedurave te likuidimit, emri i shoqerise pasohet nga shenimi "ne likuidim ".

27.5. Në fund të procesit të likuidimit Asambleja vendos , mbi bilancin përfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmërisë së punës së likuiduesit dhe mbi mbylljen e procesit të likuidimit.

27.6. Mbas pagimit të kreditorëve , likuiduesi ndan aktivet e mbetura ndërmjet aksionareve proporcionalisht me pjesët që ata zotërojnë në kapitalin e regjistruar.

**RREGULLIMI I SHOQERISE**

KANTINA GJERGJ KASTRIOTI DURRES Skënderbeu

**Neni 34**

**Vula dhe logoja**

